

Bashkimi Evropian për natyrën: mbështetje për Shqipërinë në arritjen e standardeve "Natura 2000" dhe mbrojtjen e biodiversitetit në Zonat e Mbrojtura (EU4Nature)

Duration: 01.09.2023 - 30.09.2028

Countries:
Albania

EU contribution: € 5 500 000

Total budget: € 7 552 388



Social media:

undp.org/albania/stories/eu4nature-protects-albanias-extraordinary-natural-heritage-0,
undp.org/albania/projects/eu-nature

Website(s): euprojects.al/euprojects/eu-for-nature-to-support-albania-in-achieving-natura-2000-standards-and-protect-biodiversity-in-protected-areas/

Project description:

Projekti "Bashkimi Evropian për natyrën" mbështet Shqipërinë në mbrojtjen e biodiversitetit dhe avancimin e përgatitjes së saj për rrjetin "EU Natura 2000", duke përmirësuar menaxhimin e zonave të mbrojtura, veçanërisht, të atyre me rëndësi të lartë për biodiversitetin. Ai forcon kapacitetet e institucioneve përkatëse, promovon zgjidhje të bazuara në natyrë dhe përmes monitorimit të performancës, pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe ndërgjegjësimi të synuar mbështet ruajtjen afatgjatë.

Projekti është i strukturuar rreth tetë rezultateve që kontribuojnë në objektivin e përgjithshëm të përmirësimit të efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura. Ai përfshin rishikimin dhe zhvillimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura, si dhe planeve që lidhen me përdorimin e pyjeve dhe produkteve jodrusore të pyllit; vendosjen e sistemeve të monitorimit të performancës; mbështetjen për zbatimin e masave të ruajtjes; asistencën për organizatat e shoqërisë civile, që punojnë me zgjidhje të bazuara në natyrë dhe masa kundër krimit mjedisor; si dhe ndërgjegjësimin për "Natura 2000" dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Expected results:

- □strukturë institucionale e konsoliduar dhe transpozim i përmirësuar i acquis-it të BE-së për Mbrojtjen e Natyrës;
- □kuadër ligjor i rishikuar dhe i përditësuar, përfshirë legjislacionin dytësor, mekanizmat e zbatimit dhe rolin e qartësuar të Fondit Special për Zonat e Mbrojtura;
- □plane menaxhimi të përditësuara dhe të reja për zonat e mbrojtura, habitatet dhe speciet prioritare, si dhe burimet pyjore dhe jodrusore të pyllit;
- □sisteme operative të monitorimit të performancës të vendosura dhe funksionale në zonat e zgjedhura të mbrojtura;
- □aktivitete prioritare të ruajtjes dhe të restaurimit të zbatuara në zonat e zgjedhura të mbrojtura, në bashkëpunim me NAPA-n, autoritetet rajonale dhe qeverisjen vendore;
- □organizata të shoqërisë civile që kontribuojnë aktivisht në menaxhimin e Zonave të Mbrojtura nëpërmjet një Programi të Granteve të Vogla që mbështet veprime pilote inovative, zgjidhje të bazuara në natyrë dhe iniciativa kundër krimit mjedisor.